



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 tetor 2014
Nr.ref.: RK713/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI78/14

Parashtrues

Mentor Paçak

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit,
PN. nr. 637/2013, të 16 tetorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Mentor Paçak nga Prizreni, (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), i përfaqësuar nga z. Ibrahim Paçak, nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit PN. nr. 637/2013, të 16 tetorit 2013, që pretendohet se i është dorëzuar atij në nëntor të vitit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, por parashtruesi i kërkesës nuk ka cekur ndonjë dispozitë kushtetuese.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 maj 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 18 qershor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 19 qershor 2014, Gjykata një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës së Apelit.
9. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës zëvendësoi gjyqtarin raportues Robert Carolan me gjyqtarin Almiro Rodrigues.
10. Më 16 shtator 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në një datë të pacaktuar parashtruesi i ka parashtruar kërkesë Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren për shtyrjen e fillimit të vuajtjes së dënimit me burg, i gjykuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, nr. P. nr. 49/2011 të 8 prillit 2011, i cili është bërë i plotfuqishëm me 22 mars 2012.
12. Më 29 maj 2013, Gjykata Themelore në Prizren, (Aktvendimi Ped. nr. 231/2013), aprovoi kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e fillimit të vuajtjes së dënimit me burg, për 3 (tre) muaj, ashtu që fillimi i mbajtjes së dënimit të shtyhet deri më 29 gusht 2013.
13. Në një datë të pacaktuar parashtruesi i ka parashtruar përsëri kërkesë Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren për shtyrjen e fillimit të vuajtjes së dënimit me burg.

14. Më 20 shtator 2013, Gjykata Themelore në Prizren (Aktvendimi PED. nr. 223/2013) refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e fillimit të vuajtjes së dënimit.
15. Më 16 tetor 2013, Gjykata e Apelit, (Aktvendimi PN. nr. 637/2013), e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, të 20 shtatorit 2013. Gjykata e Apelit konstatoi se *“[...] Meqenëse i dënuari nuk ka afuar kurrfarë prove që mbështesin pretendimin për shtyrje e në bazë të cilave gjykata do ta vlerësonte plotësimin apo jo të kushtit ligjor nga neni 20 par. 1 pika 1.4 të LMESP, kjo Gjykatë ka përfunduar se aktvendimi ankimor i shkallës së parë mbi refuzimin e lutjes për shtyrje dënimi është marrë në përputhje me dispozitat procedurale, e duke e zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dispozitat e LMESP, qëndrime të cilat i pranon edhe kjo gjykatë [...]”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi nuk ka cekur ndonjë shkelje të dispozitave të Kushtetutës por vetëm ka kërkuar nga Gjykata faljen e dënimit.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.
19. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi, ose [...]”.
20. Gjykata vëren se aktvendimi përfundimtar i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 637/2013, është nxjerrë më 16 tetor 2013 dhe i është dorëzuar parashtruesit në nëntor 2013. Parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 5 maj 2014, që është më shumë se 4 (katër) muaj nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar Aktvendimi i Gjykatës së Apelit.
21. Nga sa u tha më lart, Gjykata konstaton se kërkesa është e paafatshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani